V E N D I M
Nr. 268, datë 8.6.1999

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E FALIMENTIMIT DHE TË LIKUIDIMIT TË NDËRMARRJES SË MINIERËS SË QYMYRGURIT NË MEMALIAJ, TEPELENË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8140, datë 5.9.1996 «Për miratimin e dekretit nr. 1561, datë 25.7.1996 «Për një shtesë në ligjin nr. 8017, datë 25.10.1995 «Për procedurat e falimentimit», me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të shpallë falimentimin dhe të realizojë likuidimin në rrugë administrative, të Ndërmarrjes së Minierës së Qymyrgurit, Memaliaj, Tepelenë.

2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të hartojë studimin dhe projektin e mbylljes së kësaj miniere nëpërmjet ITNPM-së Tiranë. Procesi i mbylljes së minierës të përfundojë brenda vitit 1999 me fondet e mbetura, prej 17 milionë lekësh të dhëna për konservimin e disa sektorëve të kësaj miniere.

3. Pajisjet, makineritë dhe objektet të privatizohen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 20.3. 1998 ose të transferohen në minierat që janë në punë.

4. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit me shpalljen e aktit të likujdimit të ndërmarrjes emëron likujdatorin ose grup likujdatorësh pranë Minierës së Qymyrgurit Memaliaj.

5. Arkëtimet në lekë i vleftës së shitjes së pasurisë dhe detyrimeve debitore të ndërmarrjes në likuidim derdhen në llogarinë e unifikuar të thesarit. Për përcaktimin e rregullave të përdorimit Ministria e Financave dhe MEPP nxjerrin udhëzimin përkatës.

6. Punonjësit që mbeten pa punë si pasojë e falimentimit të minierës të trajtohen financiarisht me 60 milionë lekë efektet do të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për një periudhë 1 (një) vjeçare në masën 100 për qind të pagës bazë dhe të vjetërsisë në punë në çastin e shkëputjes nga puna dhe pagesa të bëhet nga Zyra e Punësimit të rrethit Tepelenë, me fondet që do të vihen në dispozicion për këtë qëllim.

7. Periudha 1(një) vjeçare për punonjësit e mbetur pa punë dhe që do të trajtohen sipas këtij vendimi, të njihet si vjetërsi pune për efekt pensioni dhe të shënohet si e tillë në librezën e punës.

8. Përfitojnë nga ky vendim të gjithë punonjësit e Ndërmarrjes së Qymyrgurit Memaliaj Tepelenë të cilët kanë qenë të punësuar pranë kësaj ndërmarrjeje pa ndërprerje që nga data 1.9.1998.

9. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit apo të vetëpunësimit. Në rast të kundërt u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko